



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I ARTEVE

PLANI I ZHVILLIMIT 2025–2030

Prill, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE	5
1. Përmbledhje ekzekutive	6
2. Qëllimi dhe profili i planit të zhvillimit.....	7
2.1. Qëllimet kryesore të planit janë:	7
2.2. Dokumenti bazohet në:.....	7
2.3. Qasja metodologjike dhe harmonizimi ndër-dokumentar	8
3. Lidhja me planin strategjik dhe planin e veprimit	9
3.1. Lidhja ndërmjet strategjisë, zhvillimit dhe planit të veprimit	9
Tabela 3 A.	9
3.2. Diagrami i lidhjes ndërmjet objektivave strategjike dhe operacionale	10
4. Zonat strategjike të ndërhyrjes dhe prioritetet zhvillimore	11
4.1. Zhvillimi i mësimdhënies dhe kurrikulës	11
4.1.1. Integrimi i Teknologjive të Avancuara në Mësimdhënie dhe Krijimtari	11
4.2. Kërkimi artistik dhe inovacioni ndërdisiplinor	12
4.3. Modernizimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi	12
4.4. Ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti akademik	13
4.4.1. Diplomacia Kulturore dhe Prezantimi Ndërkombëtar i Artit	14
4.5. Alumni, komuniteti dhe përfshirja sociale	14
4.6. Qeverisja dhe qëndrueshmëria institucionale	15
4.7. Afatet për çdo objektiv zhvillimor	16
Tabela 4 A.	16
4.8. Përgjegjësitë institucionale për zbatim	16
Tabela 4 B.	16
4.9. Indikatorët e Performancës (KPI) sipas Fushave Prioritare	16
5. Monitorimi, vlerësimi dhe përditësimi i planit.....	18
5.1. Mekanizmat kryesorë përfshijnë:	18
Tabela 5 A.	18
5.2. Mekanizmat Institucionalë për Zbatim dhe Monitorim	19

5.2.1. Zhvillimi Profesional i Stafit Jo-akademik	19
5.3. Përputhshmëria me Standardet ESG dhe KShC	20
6. Institutet dhe njësitë mbështetëse të fakultetit	21
7. Politikat për Barazi, Etikë dhe Përfshirje	23
8. Kapacitetet njerëzore dhe zhvillimi profesional	24
9. Zhvillimi i departamenteve akademike	25
10. Rreziqet dhe faktorët e suksesit në zbatim	26
Tabela 10 A.	26
10.1. Zbutja e Rreziqeve Institucionale dhe Elasticiteti ndaj Krizave	27
11. Shtojca i – objektivat dhe indikatorët (KPI)s	28
Tabela: Shtojca I.1.	28
12. Shtojca ii – tabela e buxhetit të përllogaritur (2025–2030)	29
Tabela: Shtojca II.1.	29
Tabela: Shtojca II.2.	30
13. Shtojca III – kalendari i zbatimit të planit (2025–2030)	31
Tabela: Shtojca C III.1.	31
14. SHTOJCA IV	32
14.1. Struktura institucionale.....	32
14.2. Diagrami i procesit të monitorimit dhe vlerësimit	33
15. Shtojca V: 5 objektivat strategjike të planit të zhvillimit	33
16. Shtojca VI: Projekti i kampusit të ri të fakultetit të arteve	34
16.1. Rëndësia e Objektit dhe Konteksti Aktual	34
Tabela: Shtojca VI.1.....	34
16.2. Përmbajtja e Kampusit	35
16.3. Sipërfaqja Totale	35
16.4. Investimet.....	35
16.5. Faza të zbatimit (2025–2030)	36
16.6. Justifikim strategjik.....	36
16.7. Referencë për Planin e Veprimit.....	36

17.	Shtojca VII– Politika për barazinë gjinore dhe përfshirjen	37
18.	Plani i zhvillimit 2025–2030 – pikat kyçe.....	37
19.	Ndikimi i Parashikuar Institucional dhe Kulturor	37
20.	Përfundim	38
21.	Fjalori i termave dhe shkurtesave	38
22.	Fjalor i Termave dhe Akronimeve	39

PARATHËNIE

Plani i Zhvillimit të Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030 artikulon një vizion afatgjatë të bazuar në parimet e cilësisë, përfshirjes, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe inovacionit artistik. Ky dokument është përgatitur në kuadër të përpjekjeve më të gjera për të forcuar identitetin institucional të Fakultetit si një njësi akademike me rëndësi të veçantë brenda Universitetit të Prishtinës, duke funksionuar njëkohësisht sipas një misioni dhe modeli organizativ që përputhen me ato të universiteteve të pavarura të arteve në Evropë.

Përmes këtij plani, Fakulteti angazhohet për përmirësimin e kushteve për mësimdhënie dhe kërkim artistik, ndërtimin e një kampusi të ri bashkëkohor dhe zhvillimin e politikave që adresojnë sfidat aktuale, si dhe aspiratat në zhvillim të studentëve, stafit akademik dhe komunitetit të gjerë artistik.

Plani është në përputhje të ngushtë me Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit të Fakultetit dhe përmban objektiva konkrete, indikatorë të matshëm, burime të ndara dhe një kornizë të qartë për monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim të pandërprerë.

Ky dokument është rezultat i një procesi të gjerë dhe gjithëpërfshirës që përfshin departamentet e arteve vizuale, muzikës dhe dramës dhe shërben si një platformë themelore për avancimin dhe konsolidimin e rolit të Fakultetit të Arteve si një qendër dijes, kreativiteti dhe diplomacie kulturore.

1. Përmbledhje ekzekutive

Plani i Zhvillimit i Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës për periudhën 2025–2030 është një dokument strategjik dhe operacional, që shërben si udhërrëfyes për zhvillimin akademik, krijues dhe organizativ të institucionit. Ai bazohet në pesë objektiva kryesorë të Planit Strategjik dhe operacionalizohet përmes masave konkrete të Planit të Veprimit.

Plani përfshin gjashtë fusha prioritare:

- 1. Mësimdhënia dhe Kurrikula** – reformim i kurrikulave, futje modulesh të reja dhe metodash bashkëkohore.
- 2. Kërkimi Artistik dhe Inovacioni** – ngritje e kapaciteteve për kërkim dhe krijimtari ndërdisiplinore.
- 3. Infrastruktura dhe Digjitalizimi** – përmirësim i hapësirave dhe pajisjeve moderne mësimore dhe kërkimore.
- 4. Ndërkombëtarizimi** – zgjerim i partneriteteve dhe mobilitetit të studentëve e stafit.
- 5. Alumni dhe Komuniteti** – forcim i rrjetit të alumnive dhe angazhim në projekte sociale dhe kulturore.
- 6. Qeverisja Institucionale** – përmirësim i menaxhimit, transparencës dhe qëndrueshmërisë financiare.

Monitorimi i Planit bëhet përmes indikatorëve të matshëm (KPI) të vendosur për secilën fushë, me raportim vjetor dhe vlerësim të ndërmjetëm në vitin 2027.

Në fokus është një qasje gjithëpërfshirëse, ndërdepartamentale dhe e orientuar nga cilësia, në përputhje me standardet evropiane (ESG) dhe kërkesat e KShC-së.

Ky plan është një dokument dinamik dhe do të rishikohet në vitin 2027 për të reflektuar progresin, sfidat dhe nevojat e reja institucionale në përputhje me misionin e Fakultetit.

2. Qëllimi dhe profili i planit të zhvillimit

Plani i Zhvillimit i Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030 është dokumenti strategjik dhe operacional që shërben si kornizë orientuese për zhvillimin institucional në përputhje me prioritetet akademike, artistike dhe shoqërore të fakultetit.

Ky dokument konkretizon pesë objektivat strategjike të Planit Strategjik dhe i përkthen ato në fusha prioritare të matshme dhe të zbatueshme përmes Planit të Veprimit. Në këtë mënyrë, Plani i Zhvillimit vepron si urë lidhëse ndërmjet vizionit afatgjatë dhe ndërhyrjeve konkrete, duke ndihmuar menaxhimin, vendimmarrjen dhe monitorimin e performancës.

2.1. Qëllimet kryesore të planit janë:
• Të orientojë zhvillimin e Fakultetit në përputhje me standardet evropiane të arsimit të lartë artistik dhe praktikat bashkëkohore të qeverisjes institucionale;
• Të forcojë koordinimin ndërdepartamental nëpërmjet Institutit të Fakultetit, si njësi e përbashkët për kërkimin, prezantimin dhe inovacionin;
• Të përmirësojë autonominë artistike dhe krijuese, në funksion të zhvillimit akademik dhe shoqëror të studentëve dhe stafit;
• Të shërbejë si instrument planifikues, monitorues dhe llogaridhënës, i ndërlidhur ngushtë me Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit të fakultetit;
• Të mbështesë rritjen e vizibilitetit ndërkombëtar, ndërlidhjen me komunitetin dhe angazhimin në diplomaci kulturore.
2.2. Dokumenti bazohet në:
• Kornizën ligjore për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës;
• Analizën SWOT dhe të dhënat nga vetëvlerësimi institucional;
• Objektivat strategjike të miratuar për periudhën 2025–2030;
• Planin e Veprimit të Fakultetit si mekanizëm zbatimi;
• Konsultime të strukturuar me departamentet dhe grupet e interesit;
• Parimet e përputhshmërisë me standardet ESG, zonën EHEA dhe prioritetet e integritimit evropian në arsimin e lartë.

2.3. Qasja metodologjike dhe harmonizimi ndër-dokumentar

Plani i Zhvillimit 2025–2030 i Fakultetit të Arteve është ndërtuar mbi një qasje metodologjike të integruar, në përputhje të plotë me Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit. Ai bazohet në ciklin e përmirësimit të vazhdueshëm institucional dhe përfshin komponentët e planifikimit strategjik, zbatimit operacional dhe vlerësimit sistematik.

Ky dokument vepron si hallkë lidhëse ndërmjet qëllimeve afatgjata të vizionit strategjik dhe ndërhyrjeve konkrete të Planit të Veprimit, duke siguruar koherencë tematike, përputhshmëri terminologjike dhe sinkronizim në afate, tregues dhe buxhetim.

Qasja e zbatuar metodologjike përfshin këto parime:

- **Harmonizimi ndër-dokumentar:** Çdo objektiv zhvillimor është i lidhur drejtpërdrejt me një ose më shumë objektiva strategjike dhe operacionale, në përputhje me strukturën e Planit Strategjik 2025–2030 dhe Planit të Veprimit të miratuar në prill 2025.
- **Përputhshmëria me standardet ESG dhe KShC:** Plani është ndërtuar duke respektuar standardet evropiane për sigurimin e cilësisë (ESG) dhe kriteret e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC).
- **Qasja pjesëmarrëse dhe e bazuar në evidencë:** Hartimi i planit është rezultat i konsultimeve të gjera me njësitë akademike, stafin, studentët dhe partnerët institucionalë, si dhe i analizës së vetëvlerësimit dhe dokumenteve themelore ligjore.

Në këtë mënyrë, Plani i Zhvillimit siguron që Fakulteti i Arteve të avancojë në mënyrë të qëndrueshme, transparente dhe të matshme në përputhje me standardet më të larta të arsimit të lartë artistik në Evropë.

3. Lidhja me planin strategjik dhe planin e veprimit

3.1. Lidhja ndërmjet strategjisë, zhvillimit dhe planit të veprimit

Plani i Zhvillimit i Fakultetit të Arteve (2025–2030) është ndërtuar mbi bazën e objektivave të miratuara në Planin Strategjik dhe operacionalizohet në përputhje me masat konkrete të Planit të Veprimit. Ai shërben si urë lidhëse ndërmjet qëllimeve afatgjata dhe ndërhyrjeve afatmesme të zbatueshme, duke siguruar një qasje të integruar dhe të harmonizuar në të gjitha nivelet institucionale.

Objektivat strategjikë përcaktojnë drejtimin vizionar, ndërsa Plani i Veprimit përmban masat konkrete, afatet kohore, kostot dhe indikatorët e suksesit. Plani i Zhvillimit i lidh këto dy dokumente përmes fushave prioritare të zhvillimit institucional, të cilat janë të renditura në tabelën më poshtë:


Tabela 3 A.

Fusha prioritare	Objektivi strategjik(ps)	Objektivi nga plani i veprimit (pv)
Cilësia akademike dhe kurrikula	Objektivi 1	Objektivat 1 dhe 2
Kërkimi dhe inovacioni	Objektivi 2	Objektivi 3, Shtojca A
Infrastruktura dhe digjitalizimi	Objektivi 3	Objektivi 4, Shtojca B
Ndërkombëtarizimi	Objektivi 4	Objektivi 5
Alumni dhe komuniteti	Objektivi 5	Objektivi 6

Ky sistem i trefishtë i lidhjeve siguron që çdo veprim zhvillimor në Fakultetin e Arteve të jetë i bazuar në vizionin strategjik, i udhëhequr nga një plan veprimi konkret dhe i mbështetur me indikatorë të qartë për matje dhe raportim. Kjo qasje forcon transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien institucionale gjatë gjithë periudhës 2025–2030.

3.2. Diagrami i lidhjes ndërmjet objektivave strategjike dhe operacionale

Diagrami i Lidhjes ndërmjet Objektivave Strategjike dhe Operacionale



4. Zonat strategjike të ndërhyrjes dhe prioritetet zhvillimore

4.1. Zhvillimi i mësimdhënies dhe kurrikulës

(Lidhet me Objektivin Strategjik 1 dhe Objektivat e Veprimit 1 dhe 2)

Qëllimi është përmirësimi i përvojës akademike të studentëve përmes reformimit të kurrikulës në përputhje me standardet ESG dhe me zhvillimet bashkëkohore në art, teknologji dhe nevojat e tregut. Kjo do të realizohet përmes:

- Rishikimit të të gjitha programeve BA dhe MA;
- Futjes së moduleve të reja ndërdisiplinore dhe digjitale: dizajn interaktiv, media të reja, VR/AR, inteligjencë artificiale në art, diplomaci kulturore, etj.;
- Krijimit të moduleve me fokus praktik dhe bashkëpunim me partnerë të jashtëm (galeri, teatro, studio dizajni);
- Zbatimit të metodave të mësimdhënies bashkëkohore: mentorim, punë laboratorike, projekte sfiduese me baza reale.

Objektivat konkrete:

- $\geq 85\%$ kënaqshmëri nga studentët në anketat institucionale;
- Të gjitha programet me përfshirje të praktikës profesionale;
- Kurrikula fleksibile dhe e përditësuar çdo 5 vite;
- ≥ 10 module të reja të dizajnuara deri në vitin 2030.

4.1.1. Integrimi i Teknologjive të Avancuara në Mësimdhënie dhe Krijimtari

Në funksion të modernizimit të procesit mësimor dhe rritjes së përputhshmërisë me praktikatat ndërkombëtare, Fakulteti i Arteve do të integrojë teknologjitë e reja në mënyrë funksionale në të gjitha programet studimore.

Elementët kryesorë përfshijnë:

- **Përdorimin e teknologjive të realitetit virtual dhe të shtuar (VR/AR)** në kurset e dizajnit, teatrit dhe vizualizimit skenik;
- **Aplikimin e inteligjencës artificiale (AI)** në dizajn grafik, procesim të imazhit dhe analiza të përmbajtjes vizuale;
- **Krijimin e laboratorëve digjitalë të profilizuar**, si: Lab për artin dhe IA, Lab për audio-vizion dhe teknologji skenike, Lab për animacion dhe vizatim të avancuar;

- **Integrimin e mjeteve të bashkëpunimit digjital** në mësimdhënie, përfshirë platforma për kritika online, ekspozita virtuale dhe simulime interaktive.

Këto komponentë do të mbështeten nga programet e trajnimit për stafin dhe do të përfshihen në planifikimet vjetore të investimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve teknologjike.

4.2. Kërkimi artistik dhe inovacioni ndërdisiplinor

(Lidhet me Objektivin Strategjik 2 dhe Objektivin e Veprimit 3 + Shtojca A)

Kjo fushë synon ngritjen e kapaciteteve për kërkim të bazuar në praktikë dhe zhvillimin e krijimtarisë artistike nëpërmjet laboratorëve, qendrave dhe platformave bashkëpunuese ndërdisiplinore.

Prioritetet përfshijnë:

- Funksionalizimin e Qendrës për Hulumtime Artistike si një njësi e akredituar kërkimore;
- Themelimin dhe operimin e Laboratorit për Inovacione si hapësirë për projekte ndërdisiplinore studentore dhe akademike;
- Mbështetje financiare për publikime, ekspozita dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare;
- Zhvillimin e një platforme digjitale për arkivim dhe diseminim të krijimtarisë kërkimore.
- Funksionalizimin e Institutit për Film dhe Produksion Televiziv

Objektivat konkrete:

- ≥ 10 projekte kërkimore të mbështetura në vit;
- ≥ 8 prezantime ndërkombëtare në ekspozita, shfaqje, filma, koncerte dhe konferenca çdo vit;
- ≥ 3 botime artistike ose shkencore në vit (në revista të indeksuara ose katalogë hulumtues);
- Të paktën 5 marrëveshje të reja për bashkëpunim kërkimor ndërkombëtar deri më 2030.

4.3. Modernizimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi

(Lidhet me Objektivin Strategjik 3 dhe Objektivin e Veprimit 4 + Shtojca B)

Qëllimi është përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike për të mbështetur mësimdhënien bashkëkohore, kërkimin dhe krijimtarinë ndërdisiplinore.

Prioritetet përfshijnë:

- Ndërtimin e objektit të ri të Fakultetit sipas standardeve evropiane për arsimin artistik;
- Pajisjen e departamenteve me laboratorë tematikë për artet pamore, muzikën dhe teatrin;
- Instalimin e klasave të mençura dhe pajisjeve për mësimdhënie digjitale dhe interaktive;
- Digjitalizimin e procesit akademik, të administratës dhe arkivimit të krijimtarisë.

Objektivat konkretë:

- Të gjitha njësitë me qasje në laboratorë të specializuar deri më 2030;
- ≥ 10 hapësira mësimore të rinovuara dhe të pajisura me teknologji moderne;
- Qasje 100% në softuerë profesionalë për studentët dhe stafin (Adobe, Ableton, Unity, etj.);
- Platformë funksionale për menaxhimin akademik dhe evidencën e krijimtarisë studentore.

4.4. Ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti akademik

(Lidhet me Objektivin Strategjik 4 dhe Objektivin e Veprimit 5)

Qëllimi është rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar, mobilitetit të stafit dhe studentëve, dhe përfshirjes së Fakultetit të Arteve në rrjete evropiane të edukimit dhe kulturës.

Prioritetet përfshijnë:

- Nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të reja Erasmus+ dhe programeve të tjera të BE-së;
- Zhvillimin e moduleve dhe programeve të përbashkëta në gjuhë të huaj (anglisht);
- Organizimin e shkëmbimeve akademike dhe pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta me institucione artistike ndërkombëtare;
- Angazhimin e profesorëve të huaj të ftuar dhe pjesëmarrjen e stafit në trajnime evropiane.

Objektivat konkretë:

- ≥ 10 partneritete të reja ndërkombëtare aktive deri më 2030;
- ≥ 50 studentë dhe staf të përfshirë në mobilitet ndërkombëtar çdo vit;
- Të paktën një program i përbashkët në anglisht deri në vitin 2027;
- Pjesëmarrje e rregullt në ngjarje artistike dhe arsimore evropiane (bienale, konferenca, rezidenca)

4.4.1. Diplomacia Kulturore dhe Prezantimi Ndërkombëtar i Artit

Në kuadër të politikave të ndërkombëtarizimit, Fakulteti i Arteve do të promovojë **diplomacinë kulturore** si mjet për të rritur prezencën e artit kosovar në skenën ndërkombëtare dhe për të forcuar identitetin kulturor përmes shkëmbimeve akademike dhe artistike.

Qëllimet e kësaj qasjeje përfshijnë:

- Organizimin e ekspozitave ndërkombëtare, shfaqjeve dhe koncerteve të studentëve dhe stafit në qendra kulturore evropiane;
- Themelimin e një platforme për art dhe diplomaci kulturore, që do të shërbejë si arkivë, rrjet bashkëpunimi dhe mjet për komunikim ndërkombëtar;
- Bashkëpunime me ambasada kulturore, organizata të diasporës dhe rrjete evropiane të universiteteve të arteve;
- Pjesëmarrje në aktivitete që synojnë ndikimin kulturor të artit si formë e ndërtimit të marrëdhënieve ndërkombëtare paqësore dhe kreative.

Diplomacia kulturore do të jetë pjesë e planeve vjetore të Institutit të Fakultetit dhe do të synojë integrimin e artit në politikat ndërkombëtare të edukimit, bashkëpunimit dhe zhvillimit kulturor.

4.5. Alumni, komuniteti dhe përfshirja sociale

(Lidhet me Objektivin Strategjik 5 dhe Objektivin e Veprimit 6)

Kjo fushë ka për qëllim të rrisë angazhimin e Fakultetit me komunitetin artistik dhe publikun e gjerë përmes aktiviteteve edukative, kulturore dhe qytetare, si dhe të fuqizojë rrjetin e alumneve si partnerë aktivë të zhvillimit institucional.

Prioritetet përfshijnë:

- Krijimin e rrjetit funksional të alumneve me platformë digjitale dhe aktivitete vjetore;
- Organizimin e ekspozitave, koncerteve dhe shfaqjeve publike që promovojnë artin dhe përfshirjen sociale;
- Bashkëpunimin me shkolla, komuna dhe OJQ për edukimin artistik në komunitet;
- Promovimin e barazisë, përfaqësimit dhe qasjes për grupet e marginalizuara përmes artit.

Objektivat konkretë:

- Të themelohet platforma digjitale e alumni-ve deri më 2026;
- ≥ 3 aktivitete komunitare në vit me përfshirje të studentëve;

- Të paktën 1 partneritet i strukturuar me një komunë ose shkollë për art në komunitet deri në vitin 2027;
- Politika institucionale për artin gjithëpërfshirës të miratuar deri më 2028

4.6. Qeverisja dhe qëndrueshmëria institucionale

(Lidhet me Objektivin e Veprimit 7)

Qëllimi është të forcohet menaxhimi institucional, transparenca, efikasiteti administrativ dhe qëndrueshmëria financiare e Fakultetit të Arteve në përputhje me standardet evropiane të qeverisjes në arsimin e lartë.

Prioritetet përfshijnë:

- Zhvillimin dhe zbatimin e politikave të brendshme për menaxhimin e cilësisë, burimeve njerëzore dhe etikës institucionale;
- Automatizimin dhe dixhitalizimin e proceseve administrative dhe raportimit financiar;
- Zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale për udhëheqësit akademikë dhe administrativë;
- Diversifikimin e burimeve të të ardhurave përmes projekteve, partneriteteve dhe shërbimeve artistike.

Objektivat konkretë:

- Zhvillimi dhe miratimi i manualeve të brendshme për qeverisje dhe transparencë deri në vitin 2026;
- $\geq 90\%$ e shërbimeve administrative të dixhitalizuara deri më 2030;
- Trajnime të rregullta për stafin në menaxhim institucional dhe ligjshmëri;
- Të paktën 20% e buxhetit vjetor të Fakultetit të vijë nga burime alternative deri më 2030.

4.7. Afatet për çdo objektiv zhvillimor

Tabela 4 A.

Afatet për zbatimin e objektivave zhvillimore	
OBJEKTIVI ZHVILLIMOR	AFATI I ZBATIMIT
Zhvillimi i kurrikulave dhe mësimdhënies	2025–2026
Modernizimi i infrastrukturës akademike	2026–2028
Ndërtimi i kampusit të ri	2026–2030
Krijimi i qendrave kërkimore dhe laboratorëve	2025–2027
Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar	2025–2030
Zhvillimi i platformës alumni	2026–2027
Integrimi i qasjes gjinore dhe përfshirjes	2025–2027

4.8. Përgjegjësitë institucionale për zbatim

Tabela 4 B.

Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e planit të zhvillimit		
FUSHA PRIORITARE	NJËSIA PËRGJEGJËSE KRYESORE	PARTNERËT MBËSHTETËS
Mësimdhënia dhe cilësia	Departamentet, Zyra e cilësisë	Koordinatorë kurrikulash, Dekanati
Kërkimi dhe inovacioni	Qendrat kërkimore, koordinatorët MA	Stafi akademik, partnerët kërkimorë
Ndërkombëtarizimi	Koordinatori për marrëdhënie ndërkombëtare	Erasmus+, Rrjetet evropiane
Infrastruktura	Dekanati, Drejtoria e Infrastrukturës	MASHTI, donatorë, UP
Alumni dhe komuniteti	Zyra për alumni dhe PR	Ish-studentët, institucionet kulturore
Qeverisja dhe menaxhimi	Sekretaria, Dekanati	UP, partnerë për menaxhim
Barazia dhe përfshirja	Koordinatori për barazi gjinore	Organizata të shoqërisë civile

4.9. Indikatorët e Performancës (KPI) sipas Fushave Prioritare

Në përputhje me Planin e Veprimit 2025–2030, për secilën fushë prioritare të zhvillimit janë përcaktuar indikatorë të matshëm të performancës (KPI), të cilët do të përdoren për monitorim dhe raportim vjetor institucional.

Fusha Prioritare	KPI-të Kryesore (2025–2030)
Mësimdhënia dhe Kurrikula	• $\geq 85\%$ kënaqshmëri e studentëve në anketat vjetore • ≥ 10 module të reja të përfshira • Përditësim i plotë i kurrikulave çdo 5 vite
Kërkimi dhe Inovacioni	• ≥ 10 projekte kërkimore të mbështetura në vit • ≥ 8 prezantime ndërkombëtare • ≥ 3 publikime kërkimore në vit
Infrastruktura dhe Digjitalizimi	• ≥ 10 hapësira mësimore të rinovuara • 100% qasje në softuerë profesionale • 1 platformë funksionale akademike digjitale
Ndërkombëtarizimi	• ≥ 5 marrëveshje të reja Erasmus+ • ≥ 30 studentë/staf në mobilitet ndërkombëtar • 1 program në gjuhë të huaj
Alumni dhe Komuniteti	• ≥ 5 projekte me alumni të realizuara • 1 platformë për rrjetëzim të alumnive • ≥ 3 partneritete me organizata kulturore/lokale
Qeverisja dhe Qëndrueshmëria	• 1 raport vjetor i performancës • Zbatim i buxhetit $\geq 90\%$ sipas planifikimit • 1 vlerësim i ndërmjetëm në vitin 2027

5. Monitorimi, vlerësimi dhe përditësimi i planit

Zbatimi i Planit të Zhvillimit do të mbështetet në një sistem të strukturuar të monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar përputhshmëri me objektivat strategjike dhe operative, si dhe për të mundësuar përshtatje të vazhdueshme ndaj ndryshimeve të brendshme dhe të jashtme institucionale.

5.1. Mekanizmat kryesorë përfshijnë:

- Emërimin e një Koordinatori për Zhvillim Strategjik brenda Fakultetit;
- Raportim vjetor për secilin objektiv zhvillimor në përputhje me indikatorët e Planit të Veprimit;
- Takime periodike me drejtuesit e departamenteve dhe njësive për të vlerësuar progresin;
- Përfshirje të studentëve dhe alumni-ve në vlerësim përmes anketave dhe fokus-grupeve;
- Hartimin e një raporti të ndërmjetëm në vitin 2027 dhe një rishikim të plotë në vitin 2030.

Tabela 5 A.

Verësimi për çdo objektiv:				
Objektivi	Kpi kryesor	Burimi i të dhënave	Frekuenca e vlerësimit	Përgjegjësitë
Zhvillimi i kurrikulës	% e programeve të rishikuara	Raportet e departamenteve	Vjetore	Komisionet akademike
Kërkimi dhe inovacioni	Nr. i projekteve kërkimore	Raportet e Qendrës për Hulumtime, dhe Institutit për Film dhe produksion Televiziv	Vjetore	Drejtoria e Instituteve
Infrastruktura dhe digjitalizimi	Nr. i laboratorëve funksionalë	Raporte teknike dhe financiare	Gjithë 2 vjet	Administrata dhe Prodekanati
Ndërkombëtarizimi	Nr. i partneriteteve të reja	Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar	Gjithë 2 vjet	Koordinatori Erasmus+
Alumni dhe komuniteti	Nr. i aktiviteteve me publikun	Evidenca e eventeve dhe anketat	Vjetore	Zyra Alumni, Departamentet
Qeverisja institucionale	% e shërbimeve të digjitalizuara	Sistemi i menaxhimit institucional	Gjithë 3 muaj	Sekretaria dhe IT

Këto masa synojnë të forcojnë:

- Llogaridhënien e strukturave përkatëse;
- Transparencën dhe dokumentimin institucional;
- Krijimin e një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm;
- Mbështetjen në vendimmarrje bazuar në të dhëna.

Në fund të çdo viti do të përgatitet një Raport Monitorimi, i cili do të përmbajë analizën e arritjeve dhe rekomandimet për përmirësime të mëtejshme. Në vitin 2027 do të bëhet një rishikim i ndërmjetëm, ndërsa në vitin 2030 do të realizohet një vlerësim i përgjithshëm për mbylljen e ciklit të planit dhe nisjen e hartimit të planit pasues.

5.2. Mekanizmat Institucionalë për Zbatim dhe Monitorim

Për të garantuar zbatim të koordinuar, transparent dhe të matshëm të objektivave të përcaktuara në këtë Plan, Fakulteti i Arteve ka përcaktuar mekanizma të qartë institucionalë për monitorimin dhe raportimin e progresit.

Këta mekanizma janë:

- **Grupi për Monitorim Strategjik**, i përbërë nga përfaqësues të të tri departamenteve, Zyrës për Cilësi, administratës dhe studentëve. Ky grup ka mandat për të ndjekur zbatimin e planit dhe për të dhënë rekomandime për përmirësim të vazhdueshëm.
- **Zyra për Sigurimin e Cilësisë**, e cila mbledh dhe përpunon të dhënat për realizimin e objektivave, përdorimin e burimeve dhe arritjen e indikatorëve të performancës.
- **Raportimi vjetor dhe i ndërmjetëm**, i cili do të hartohet mbi bazën e të dhënave të mbledhura dhe do t'i dorëzohet forumeve drejtuese të Fakultetit dhe organeve të Universitetit të Prishtinës.
- **Rishikimi i Planit në vitin 2027**, që do të përfshijë analizën e progresit, përshtatjen e objektivave dhe rivlerësimin e indikatorëve të performancës.

Këta mekanizma janë të lidhur ngushtë me Kapitullin 8 të Planit të Veprimit dhe sigurojnë përputhshmëri të plotë me standardet ESG dhe kërkesat e KShC-së për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

5.2.1. Zhvillimi Profesional i Stafit Jo-akademik

Përveç zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve akademike, Fakulteti i Arteve synon të forcojë aftësitë profesionale të stafit administrativ dhe teknik përmes një programi sistematik trajnimesh.

Fushat prioritare për trajnime do të përfshijnë:

- Përdorimi i sistemeve digjitale të menaxhimit të të dhënave (si SIMS, platformat për regjistrimin e notave, arkivimi elektronik, etj.);
- Zhvillimi i aftësive ndërpersonale dhe menaxheriale, përfshirë etikën institucionale, komunikimin efektiv dhe menaxhimin e kohës;
- Njohja me standardet ESG dhe kërkesat e KShC-së për dokumentim dhe administrim të cilësisë;
- Trajnime për përgatitjen e dokumenteve zyrtare në dy gjuhë, në përputhje me kërkesat e akreditimit dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Qëllimi është që të gjithë anëtarët e stafit jo-akademik të kenë mundësi zhvillimi të barabartë dhe të jenë të përfshirë në procesin e përmirësimit të performancës institucionale.

5.3. Përputhshmëria me Standardet ESG dhe KShC

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të Planit të Zhvillimit është ndërtuar në përputhje të plotë me udhëzuesin evropian për sigurimin e cilësisë (ESG – Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area) dhe me standardet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC).

Kjo përputhje siguron që:

- Politikat për cilësinë të jenë të bazuara në ciklin e përmirësimit të vazhdueshëm institucional (ESG 1.1);
- Studentët të jenë të përfshirë në proceset e monitorimit dhe të kenë ndikim përmes feedback-ut (ESG 1.3);
- Raportet institucionale të jenë publike dhe të aksesueshme (ESG 1.7);
- Strategjia të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes monitorimit dhe vlerësimeve periodike (ESG 1.9).

Kjo strukturë i mundëson Fakultetit të jetë jo vetëm në përputhje me kriteret për akreditim kombëtar, por edhe të pozicionohet si institucion që zbaton parimet më të avancuara të cilësisë në arsimin e lartë në nivel evropian.

6. **Institutet** dhe njësitë mbështetëse të fakultetit

Për të përforcuar zbatimin ndërdepartamental të Planit të Zhvillimit, Fakulteti i Arteve ka inicuar themelimin e një Instituti të brendshëm gjithëpërfshirës, i cili do të përbëhet nga tri njësi thelbësore:

- **Qendra për Hulumtime Artistike**, që do të koordinojë kërkimin shkencor dhe praktikën artistike ndërdisiplinore në bashkëpunim me të tri departamentet;
- **Galeria e Arteve**, si platformë publike për prezantimin e krijimtarisë së studentëve dhe stafit akademik – aktualisht funksionale dhe aktive në organizimin e ekspozitave dhe aktiviteteve kulturore;
- **Laboratori për Inovacione**, i cili do të mbështesë zhvillimin teknologjik, bashkëpunimet me industrinë kreative dhe inkubimin e ideve të reja për studentë dhe pedagogë.

Përveç njësive të reja, Fakulteti tashmë disponon Galerinë, Teatrin dhe Sallën e Koncerteve, të cilat shërbejnë si infrastrukturë thelbësore për realizimin e objektivave akademike, artistike dhe komunitare. Këto hapësira do të integrohen në funksionet e Institutit dhe do të përdoren për të mbështetur zbatimin praktik të Planit të Zhvillimit.

Në këtë kuadër, edhe Departamenti i Dramës është në proces përgatitor për themelimin e një Instituti të specializuar për Film dhe Produksion Televiziv, i cili do të veprojë si njësi e dedikuar për zhvillimin e praktikave bashkëkohore në fushën e kinemasë, televizionit dhe medias vizuale. Ky institut do të ketë për qëllim:

- Ngritjen e kapaciteteve kreative dhe teknike për studentët e aktrimit dhe regjisë;
- Realizimin e produksioneve të pavarura dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e filmit;
- Mbështetjen e projekteve të reja në skenaristikë, regji, post-produksion dhe media digjitale;
- Krijimin e platformave për ekspozimin publik të filmave studentorë dhe për ndërlidhje me industrinë.

Instituti për Film dhe Produksion Televiziv pritet të jetë pjesë integrale e Institutit të Fakultetit, duke shtuar një dimension të specializuar në qasjen ndërdisiplinore të artit bashkëkohor dhe edukimit mediatik.

Objektivat e planifikuara për Institutet (2025–2030):

- Të formalizohen dhe funksionalizohen brenda vitit 2026;

- Të zhvillojnë dhe koordinojnë ≥ 3 projekte ndërdepartamentale çdo vit pas themelimit;
- Të sigurojnë të ardhura përmes projekteve kombëtare dhe rajonale në vlerë prej $\geq 20,000$ € në vit;
- Të mbështesin zbatimin e KPI-ve të Planit të Zhvillimit dhe Planit të Veprimit;
- Të përfshijnë njësinë për film dhe TV në rrjetin e projekteve dhe partneriteteve ndërkombëtare në artet pamore, performative dhe mediatike.

7. Politikat për Barazi, Etikë dhe Përfshirje

Fakulteti i Arteve angazhohet për të ndërtuar një mjedis të barabartë, gjithëpërfshirës dhe etik për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik. Këto parime janë të integruara në misionin dhe praktikën institucionale dhe lidhen drejtpërdrejt me Objektivin 7 të Planit të Veprimit dhe politikat për etikë e integritet të Planit Strategjik.

Qëllimet kryesore përfshijnë:

- Promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha nivelet institucionale;
- Eliminimin e çdo forme të diskriminimit, ngacmimit dhe paragjykit në mjedisin universitar;
- Mbështetjen e grupeve të marginalizuara dhe përfshirjen sociale të të gjitha kategorive të studentëve;
- Zbatimin e politikave të etikës akademike dhe integritetit në të gjitha proceset mësimore, krijuese dhe menaxheriale.

Për zbatimin e këtyre politikave, Fakulteti do të përdorë mekanizmat ekzistues institucionale:

- **Komisioni për Etikë dhe Barazi**, i cili do të monitorojë zbatimin e masave dhe do të japë rekomandime për përmirësim;
- **Koordinatori për Barazi dhe Diversitet**, i cili do të jetë pika e kontaktit për çështjet e përfshirjes sociale;
- **Zyra për Cilësi**, e cila do të përfshijë indikatorë për barazi dhe përfshirje në raportimet vjetore.

8. Kapacitetet njerëzore dhe zhvillimi profesional

Për realizimin e Planit të Zhvillimit, burimet njerëzore të Fakultetit përbëjnë një faktor kyç. Rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional janë thelbësore për të siguruar zbatim cilësor, inovacion dhe qëndrueshmëri.

Nevoja strategjike:

- Rekrutim i stafit të ri akademik në fusha ndërdisiplinore (media të reja, diplomaci kulturore, dizajn digjital);
- Trajnime për stafin aktual mbi metodologjitë moderne të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë;
- Zhvillimi i kapaciteteve për kërkim artistik dhe menaxhim projektesh ndërkombëtare;
- Përfshirja e stafit teknik dhe administrativ në trajnime për menaxhim të sistemit digjital dhe transparencë institucionale.

Objektivat:

- ≥ 5 anëtarë të rinj të stafit të rekrutuar deri më 2027;
- Trajnime vjetore për të gjithë stafin mbi inovacionin pedagogjik;
- ≥ 3 projekte të udhëhequra nga stafi i ri deri më 2030;
- Vlerësim i performancës së stafit çdo 2 vite për zhvillim të qëndrueshëm.

9. Zhvillimi i departamenteve akademike

Për të siguruar një zhvillim të balancuar dhe të orientuar drejt cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse, Fakulteti i Arteve parashikon qasje të përshtatura për secilin nga tre departamentet e tij: Artet e Bukura, Muzikë dhe Dramë.

Departamenti i Arteve të Bukura:

- Zgjerimi i moduleve digjitale dhe ndërdisiplinore (VR/AR, dizajn bashkëkohor, media të reja);
- Mbështetje për laboratorë të teknologjisë vizuale dhe platforma ekspozuese digjitale;
- Ndërlidhje me modulet e muzikës dhe performancës për projekte të përbashkëta.

Departamenti i Muzikës:

- Rritja e bashkëpunimeve ndërkombëtare për programe të përbashkëta në muzikologji dhe kompozim për media;
- Digjitalizimi i edukimit muzikor përmes softuerëve të avancuar (p.sh. Ableton, Sibelius);
- Krijimi i kurseve të ndërthurura me artet pamore dhe teatrin për performanca ndërdisiplinore.

Departamenti i Dramës:

- Zhvillimi i platformave për teatrin digjital dhe artet performative të reja;
- Fuqizimi i bashkëpunimit me teatro lokale dhe festivale për praktikë profesionale të studentëve;
- Krijimi i moduleve për aktim në hapësira jo-tradicionale dhe art politik/socio-kritik.

Ky kapitull siguron që çdo departament të ruajë specifikën e vet akademike, duke kontribuar në mënyrë të barabartë në vizionin e përbashkët të Fakultetit si qendër e avancuar e edukimit artistik në Kosovë dhe më gjerë.

10. Rreziqet dhe faktorët e suksesit në zbatim

Zbatimi i Planit të Zhvillimit mund të përballlet me një sërë sfidash që lidhen me burimet njerëzore, financiare dhe kontekstin institucional. Për ta adresuar këtë, fakulteti ka identifikuar rreziqet kryesore dhe ka propozuar masa parandaluese dhe faktorë kyç për sukses.

Tabela 10 A.

Rreziku kryesor	Masa parandaluese	Faktorët e suksesit
Mungesë fondesh për projekte dhe investime	Kërkesa për buxhet shtesë nga UP, aplikime në projekte kombëtare/BE	Qasje proaktive në financime alternative, partneritete me donatorë
Ngarkesa e lartë administrative për stafin akademik	Rishpërndarje e detyrave, digjitalizim i proceseve	Koordinim efektiv dhe trajnime për efikasitet
Mungesë motivimi për angazhim në kërkim dhe inovacion	Lidhje e performancës me avancimin akademik; grante të brendshme	Kulturë mbështetëse për kërkim dhe kreativitet
Vonesë në miratimin e dokumenteve të brendshme ose strukturave të reja	Komunikim i hershëm me organet drejtuese të UP	Pjesëmarrje aktive e menaxhmentit dhe dekanatit
Ndryshime të shpejta në politikat arsimore	Fleksibilitet në planifikim dhe përshtatje periodike	Mekanizëm i integruar për rishikim të planit

Këto elemente do të monitorohen krahas KPI-ve të planit, për të siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve institucionale.

10.1. Zbutja e Rreziqeve Institucionale dhe Elasticiteti ndaj Krizave

Fakulteti i Arteve e konsideron menaxhimin e rreziqeve si pjesë thelbësore të planifikimit të qëndrueshëm. Përveç identifikimit të rreziqeve operationale dhe strategjike, siç përshkruhen më sipër, plani parashikon edhe zhvillimin e mekanizmave për t'i përballuar ato në mënyrë fleksibile dhe afatgjatë.

Ky elasticitet institucional do të mbështetet përmes:

- Krijimit të një njësie të brendshme për menaxhimin e krizave, me përfaqësues nga të tri departamentet dhe administrata;
- Përfshirjes së moduleve të menaxhimit të rrezikut dhe edukimit për emergjenca në trajnime për stafin akademik dhe administrativ;
- Sigurimit të mjeteve alternative për vazhdimësinë e mësimit dhe punës, si mjetet online, platformat për mësim në distancë dhe digjitalizimi i plotë i dokumentacionit institucional;
- Krijimit të një fonde emergjente të brendshme që do të mbulojë nevoja të papritura teknike apo sociale (p.sh. për studentë me vështirësi).

Këto masa do të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshmërisë institucionale dhe në ruajtjen e cilësisë edhe në kushte të paparashikueshme.

11.Shtojca i – objektivat dhe indikatorët (KPI)s

Tabela: Shtojca I.1.

Fusha	Objektivi	Kpi	Afati	Njësia përgjegjëse
Mësimdhënia	Rishikimi i kurrikulave	100% e programeve të rishikuara	2026	Komisionet akademike
Kërkimi	Projekte kërkimore të mbështetura	≥ 10 /vit	Çdo vit	Qendra për Hulumtime
Infrastruktura	Laboratorë funksionalë	100% e njësive	2030	Administrata
Ndërkombëtarizimi	Partneritete të reja	≥ 10	2030	Koordinatori Erasmus+
Alumni	Platforma dhe aktivitete	Platforma + ≥ 3 aktivitete/v	2026	Zyra Alumni
Qeverisja	Digitalizimi i shërbimeve	$\geq 90\%$	2030	Sekretaria, IT

12.Shtojca ii – tabela e buxhetit të përlllogaritur (2025–2030)

Tabela: Shtojca II.1.

Fusha prioritare	Aktiviteti kryesor	Vlera e përlllogaritur (€)	Burimi i financimit	Koment
Mësimdhënia dhe Kurrikula	Rishikim programesh, module të reja	62,000	Buxheti i UP + projekte IPA	Fokus BA & MA
Kërkimi dhe Inovacioni	Mbështetje për kërkime dhe laboratorë	332000	Grante, Erasmus+, IPA	Përfshin Qendrën dhe Laboratorin
Infrastruktura dhe Digjitalizimi	Pajisje, klasat e mençura	595,000	Buxheti i UP, donacione	Përfshin 3 departamente
Ndërkombëtarizimi	Mobilitet, programe të përbashkëta	122,000	Erasmus+, partnerë	Fokusi në gjuhë të huaja
Alumni dhe Komuniteti	Platformë alumni, aktivitete	47,000	Fakulteti, partnerë lokalë	Përfshirje komunitare
Qeverisja Institucionale	Sisteme digjitale dhe trajnime	23,000	UP + donacione	IT + menaxhim
Kosto për dizajn dhe publikim të planit	Kosto për dizajn dhe publikim të planeve	5, 000	Buxheti i UP,	Përfshin: Planin strategjik, Planin e veprimt, Planin e zhvillimit
Etika dhe pronësia intelektuale		23,500	UP, BE, partnerë OJQ	Manuale, trajnime, databazë krijuese
TOTALI I PËRLLLOGARITUR (2025–2030): 1,209.000 €				
<i>Ky buxhet është orientues dhe mund të rishikohet çdo vit në përputhje me prioritetet dhe mundësitë financiare të Fakultetit dhe partnerëve strategjikë.</i>				

Tabela: Shtojca II.2.

Buxheti i përgjithshëm për planin e zhvillimit		
Fusha prioritare	Shuma e vlerësuar (€)	Burimi i financimit
Mësimdhënia dhe cilësia	550,000	UP, Erasmus+, projekte zhvillimore
Kërkimi dhe inovacioni	380,000	IPA, Horizon Europe, partnerë ndërkombëtarë
Ndërkombëtarizimi	250,000	Erasmus+, rrjete artistike evropiane
Infrastruktura dhe kampusi	14,000,000	Buxhet shtetëror, UP, donatorë strategjikë
Alumni dhe komuniteti	30,000	Fakulteti, partnerë lokalë
Qeverisja institucionale	45,000	UP, projekte me partnerë
Barazia gjinore dhe përfshirja	75,000	UP, OJQ, donacione ndërkombëtare
TOTAL	15,330,000	


13. Shtojca III – kalendari i zbatimit të planit (2025–2030)

Kalendari Vizual i Zbatimit më poshtë paraqet fazat kyçe të zbatimit dhe të vlerësimit të Planit të Zhvillimit për periudhën 2025–2030. Ai ndihmon në paraqitjen e progresit të parashikuar, pikave kritike dhe të afateve për rishikim dhe reflektim strategjik.

Tabela: Shtojca C III.1.

Nr.	Viti	Ngjarja kryesore
1.	2025	Rishikimi i kurrikulave dhe fillimi i moduleve të reja
2.	2026	Zbatimi i moduleve ndërdisiplinore dhe trajnime për staf
3.	2027	Rishikimi i parë i planit të zhvillimit dhe raporti vjetor institucional
4.	2028	Zgjerimi i infrastrukturës dhe laboratorëve tematikë
5.	2029	Rritja e mobilitetit dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare
6.	2030	Vlerësimi përfundimtar i periudhës së planit dhe rishikimi strategjik Paraqet fazat kyçe të zbatimit dhe të vlerësimit të Planit të Zhvillimit në mënyrë të vizualizuar për periudhën 2025–2030. Ai ndihmon në paraqitjen e progresit të parashikuar, pikave kritike dhe të afateve për rishikim dhe reflektim strategjik.

KALENDARI I ZBATIMIT TË PLANIT (2025–2030)



14. SHTOJCA IV

14.1. Struktura institucionale




Figura 1. Struktura organizative e Fakultetit të Arteve.

14.2. Diagrami i procesit të monitorimit dhe vlerësimit

Kjo shtojcë përmban diagramin vizual të procesit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planit të Zhvillimit të Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030. Ky proces përfshin katër faza të ndërlidhura: mbledhja e të dhënave, vlerësimi i progresit, raportimi me rekomandime dhe rishikimi periodik. Cikli është i ndërtuar për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm, transparencë dhe përshtatshmëri institucionale.




Figura: Procesi i Monitorimit dhe Vlerësimit

15. Shtojca V: 5 objektivat strategjike të planit të zhvillimit

1. Rritja e cilësisë akademike dhe përmirësimi i kurrikulës
2. Zhvillimi i kapaciteteve për kërkim artistik dhe inovacion ndërdisiplinor
3. Modernizimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi i proceseve
4. Ndërkombëtarizimi dhe forcimi i bashkëpunimit me partnerë evropianë
5. Angazhimi i alumneve dhe komunitetit për ndikim më të gjerë shoqëror

16. Shtojca VI: Projekti i kampusit të ri të fakultetit të arteve

16.1. Rëndësia e Objektit dhe Konteksti Aktual

Fakulteti i Arteve është njësi akademike e themeluar në kuadër të Universitetit të Prishtinës që nga viti 1973, me një kontribut të pazëvendësueshëm në zhvillimin e artit, kulturës dhe edukimit artistik në Kosovë. Pavarësisht këtij roli të rëndësishëm, Fakulteti ende nuk posedon një objekt të vetëm dhe të dedikuar për funksionimin e tij. Aktualisht, procesi mësimor dhe aktivitetet akademike zhvillohen në tri objekte të ndara fizikisht, çka pengon integrimin funksional të njësive dhe bashkëpunimin ndërdisiplinar mes studentëve dhe stafit akademik.

Ndërtimi i një kampusi të ri, të përbashkët dhe modern, i përfshirë në Planin e Zhvillimit 2025–2030 të Fakultetit, është një domosdoshmëri strategjike për përmbushjen e standardeve bashkëkohore të arsimit të lartë artistik. Ky kampus do të krijojë kushte të barabarta për të gjitha profilet, do të mundësojë rritjen e cilësisë akademike dhe artistike, dhe do ta forcojë identitetin institucional të Fakultetit të Arteve si qendër lider në rajon për edukim, kërkim dhe krijimtari në fushën e arteve vizuale, muzikës dhe dramës.

Tabela: Shtojca VI.1.

Fusha	Përmbajtja
Titulli i Shtojcës	Projekti i Ndërtimit të Kampusit të Ri të Fakultetit të Arteve
Qëllimi	Të sigurojë një mjedis të integruar, funksional dhe bashkëkohor për zhvillimin e tri njësive akademike të Fakultetit të Arteve: Arte Vizuale, Muzikë dhe Dramë.
Përshkrimi i shkurtër	Ky projekt parasheh ndërtimin e një kampusi të pavarur dhe të specializuar që reflekton strukturën e universiteteve më të avancuara të arteve në Evropë. Ai do të ofrojë infrastrukturë për prodhim artistik, kërkim shkencor, diplomaci kulturore dhe bashkëpunim ndërkombëtar.
Rëndësia strategjike	Kampusi i ri e forcon identitetin e Fakultetit si institucion i veçantë dhe strategjik për zhvillimin e kulturës dhe arsimit artistik në Kosovë. Projekti është i lidhur ngushtë me objektivat e Planit Strategjik dhe të Planit të Veprimit 2025–2030.
Përfituesit kryesorë	Studentët, profesorët, artistët vendas dhe të huaj, komuniteti kulturor, partnerët ndërkombëtarë.
Përputhshmëria	Projekti është në përputhje me standardet e institucioneve evropiane të arsimit të lartë në artet pamore, performative dhe muzikore, si dhe me politikat zhvillimore të Universitetit të Prishtinës.
Rezultati i pritshëm	Ndërtimi i një kampusi funksional, tërheqës dhe të pajisur me të gjitha komponentët fizikë, teknologjikë, digjitalë dhe krijues që i nevojiten një universiteti të artit të shekullit XXI.

16.2. Përmbajtja e Kampusit

Kampusi do të përfshijë:

- Fakultetin e Arteve Vizuale me të gjitha atelietë dhe laboratorët
- Fakultetin e Muzikës me hapësira për interpretim, kompozim dhe incizim
- Fakultetin e Dramës me teatër, skenografi, studio filmike dhe kinema
- Galeri për ekspozita studentore, të profesorëve, krijuesve vendor dhe ndërkombëtar
- Institute kërkimore dhe qendra për diplomaci kulturore
- Studio të teknologjisë së avancuar, AI dhe realitet virtual
- Qendra për ndërmarrësi kreative dhe edukim ndërdisiplinar
- Rezidenca për artistë, muze interaktiv, hapësira publike dhe rekreative

16.3. Sipërfaqja Totale

Komponenti	Sipërfaqe (m ²)
Komponentë akademikë bazë	8,200
Galeri, librari, shop	800
Administratë dhe mbështetje	900
Komponentë modernë shtesë	2,950
Totali i përgjithshëm	12,850

16.4. Investimet

Kategoria e investimit	Vlera (€)
Ndërtimi fizik	14,265,000
Pajisje teknologjike dhe laboratorë	1,500,000
Mobilim dhe softuerë	800,000
Galeri dhe studio profesionale	1,250,000
Totali i investimit	17,815,000

16.5. Faza të zbatimit (2025–2030)

2025:	Hartimi i projektit, dokumentacioni teknik, sigurimi i financimit
2026–2027:	Ndërtimi i objekteve për Arte Vizuale dhe Administratë
2028:	Ndërtimi i objekteve për Muzikë dhe Dramë, sallat e performances
2029:	Instalimi i teknologjive dhe mobilimi i plotë
2030:	Aktivizimi i qendrave për kërkim, inovacion dhe diplomaci kulturore

Për vitin 2025, Universiteti i Prishtinës ka ndarë një shumë prej 400,000 € për fazën fillestare të projektit të kampusit të ri të Fakultetit të Arteve. Kjo shumë do të mbulojë hartimin e projektit ideor dhe teknik, studimet paraprake dhe procedurat e para ndërtimore. Megjithatë, realizimi i plotë i projektit do të varet nga buxhetimi vjetor institucional, i cili miratohet nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës dhe i ndahet njësive akademike sipas prioritetëve strategjike. Prandaj, të gjitha vlerësimet financiare të prezantuara në këtë plan janë orientuese dhe i nënshtrohen rishikimit të përvitshëm.

16.6. Justifikim strategjik

Ky kampus do të shërbejë jo vetëm për edukim formal, por edhe si qendër kombëtare për zhvillimin e artit, diplomacinë kulturore dhe ndërlidhjen me rrjetet evropiane të universiteteve të arteve.

16.7. Referencë për Planin e Veprimit

Ky projekt është i inkorporuar si masë prioritare në Planin e Veprimit të Fakultetit të Arteve 2025–2030 dhe mbështetet nga objektivat strategjike institucionale.

17. Shtojca VII– Politika për barazinë gjinore dhe përfshirjen

Fakulteti i Arteve, në kuadër të Planit të tij të Zhvillimit 2025–2030, e trajton barazinë gjinore dhe përfshirjen si element thelbësor për ndërtimin e një mjedisi të drejtë, të sigurt dhe gjithëpërfshirës akademik. Politikat zhvillimore parashikojnë qasje të barabartë për të gjitha gjinitë në pranimin e studentëve, mbështetje të balancuar në zhvillimin profesional të stafit akademik dhe angazhim të qëndrueshëm në përfshirjen e grupeve të marginalizuara në jetën institucionale.

Një ndër prioritetet në kuadër të këtij plani është avancimi i përfaqësimit gjinor në organet vendimmarrëse dhe krijimi i mekanizmave të brendshëm për matjen dhe promovimin e përfshirjes. Politikat zhvillimore do të mbështeten me instrumente si trajnime, platforma bashkëpunimi dhe monitorim sistematik për progresin në fushën e barazisë.

18. Plani i zhvillimit 2025–2030 – pikat kyçe

Fakulteti i Arteve synon të:

1. Reformojë kurrikulën në përputhje me standardet ESG
2. Zhvillojë laboratorë inovativë dhe hulumtim artistic
3. Risë ndërkombëtarizimin dhe programet në anglisht.
4. Përmirësojë infrastrukturën për artet vizuale, muzikën dhe teatrin.
5. Forcojë lidhjet me komunitetin dhe alumnistët.
6. Plani përfshin KPI, buxhet, kalendar zbatimi dhe mekanizma monitorimi

19. Ndikimi i Parashikuar Institucional dhe Kulturor

Zbatimi i Planit të Zhvillimit 2025–2030 pritet të ketë një ndikim afatgjatë dhe transformues në kapacitetet institucionale të Fakultetit të Arteve dhe në rolin e tij brenda dhe jashtë Universitetit të Prishtinës.

Ky ndikim do të manifestohet në disa dimensione kyçe:

- **Institucionalisht**, fakulteti do të funksionojë mbi baza të qarta të qeverisjes, menaxhimit të burimeve dhe sigurimit të cilësisë, me një kulturë vendimmarrjeje të bazuar në evidencë dhe në përfshirje të gjerë të aktorëve të brendshëm.
- **Akademikisht**, studentët dhe stafi do të përfitojnë nga një mjedis mësimor i modernizuar, i digjitalizuar dhe i ndërkombëtarizuar, me mundësi të reja për mentorim, mobilitet dhe bashkëpunim kërkimor.
- **Kulturorisht**, Fakulteti do të afirmohet si qendër dinamike për prodhimin, prezantimin dhe promovimin e artit bashkëkohor në Kosovë dhe rajon, me ndikim të shtuar në diplomacinë kulturore dhe zhvillimin kreativ të komuniteteve lokale.

Këto përfitime do të jenë rezultat i një qasjeje të planifikuar, gjithëpërfshirëse dhe të mbështetur në standarde të larta të cilësisë dhe profesionalizmit institucional.

20. Përfundim

Plani i Zhvillimit 2025–2030 i Fakultetit të Arteve përfaqëson një dokument strategjik gjithëpërfshirës, i cili përkthen vizionin institucional në masa të zbatueshme dhe të matshme. Duke u mbështetur në parimet e barazisë, cilësisë dhe përfshirjes, ky plan synon të ndërtojë një mjedis akademik bashkëkohor që i përgjigjet sfidave të shekullit XXI në fushën e artit dhe edukimit artistik.

Ky dokument nuk është vetëm udhërrëfyes për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e proceseve ekzistuese, por edhe një platformë për ndryshim afatgjatë dhe për krijimin e një kulture akademike që promovon inovacionin, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin krijues të komunitetit.

Përmes këtij plani, Fakulteti i Arteve e afirmon rolin e tij si qendër dinamike e artit bashkëkohor, lidërsipit kulturor dhe edukimit të gjeneratave të reja krijuese në Kosovë dhe më gjerë.

Për të ruajtur vazhdimësinë institucionale dhe cilësinë e planifikimit afatgjatë, Fakulteti i Arteve do të përdorë këtë plan si bazë për hartimin e ciklit të ardhshëm të zhvillimit për periudhën pas vitit 2030. Procesi i rishikimit do të fillojë në vitin 2029, në përputhje me rishikimin e planit strategjik dhe raportin përfundimtar të zbatimit të Planit të Veprimit.

Kjo qasje do të sigurojë që përparimi i arritur gjatë periudhës 2025–2030 të institucionalizohet dhe të shërbejë si themel për objektiva të rinj, të bazuar në vlerësime të matshme, analiza kontekstuale dhe përvojë të akumuluar.

21. Fjalori i termave dhe shkurtesave

Nr.	Shkurtesa	Përshkrimi
1.	UP	Universiteti i Prishtinës
2.	FA	Fakulteti i Arteve
3.	BA/MA	Bachelor / Master i Arteve
4.	ESG	Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë
5.	EHEA	Zona Evropiane e Arsimit të Lartë
6.	KPI	Tregues Kyç i Performancës
7.	IPA	Instrument për Ndihmë Para-Anëtarësimit
8.	KShC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
9.	QA	Sigurimi i Cilësisë
10.	ICT	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
11.	NCP	Pika Kombëtare e Kontaktit
12.	VR/AR	Realitet Virtual / Realitet i Shtuar
13.	AI	Inteligjencë Artificiale

22. Fjalor i Termave dhe Akronimeve

Termi / Akronimi	Përshkrimi
Fakulteti i Arteve	Njësia akademike që ofron programe në artet vizuale, muzikë dhe dramë
Universiteti i Prishtinës	Institucioni amë ku bën pjesë Fakulteti i Arteve
Plani i Zhvillimit	Dokumenti që orienton zhvillimin institucional 2025–2030
Plani Strategjik	Dokumenti kryesor që përmban objektivat afatgjata të fakultetit
Plani i Veprimit	Korniza operacionale për zbatimin e strategjisë
Objektiv Strategjik (OS)	Qëllim afatgjatë institucional
Objektiv Operacional (OO)	Qëllim konkret, i zbatueshëm dhe i matshëm
Fusha Prioritare	Zonë kryesore ndërhyrjeje në zhvillimin institucional
KPI – Indikatorë të Performancës	Tregues për matjen e arritjes së objektivave
ESG – Standardet Evropiane të Cilësisë	Udhëzuesi evropian për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë
KShC – Këshilli Shtetëror i Cilësisë	Trupi kombëtar përgjegjës për akreditimin dhe cilësinë
Vetëvlerësim	Proces reflektimi dhe analize nga brenda institucionit
Qeverisje	Sistemi i drejtimit dhe menaxhimit institucional
Digjitalizim	Përdorimi i teknologjisë në funksione akademike dhe administrative
Ndërkombëtarizim	Procesi i hapjes drejt bashkëpunimeve dhe rrjeteve globale
Përfshirje Sociale	Pjesëmarrje e barabartë dhe mbështetje për të gjithë studentët
Barazi gjinore	Trajtim i drejtë dhe mundësi të barabarta për të gjitha gjinitë
Komisioni për Etikë dhe Barazi	Strukturë institucionale për mbikëqyrje të standardeve etike
Zyra për Sigurimin e Cilësisë	Njësia përgjegjëse për monitorimin e cilësisë akademike
Grupi për Monitorim Strategjik	Strukturë e përbashkët për vlerësimin e zbatimit të planit
Rishikim i Ndërmjetëm	Vlerësim në mes të periudhës së zbatimit të planit
Kampusi i Ri	Objekti i planifikuar për akomodimin modern të fakultetit
Diplomaci Kulturore	Nismat e komunikimit dhe përfaqësimit ndërkombëtar përmes artit
Bashkëpunim Ndërdisiplinor	Ndërveprim ndërmjet fushave të ndryshme artistike dhe shkencore
Institutet e Fakultetit	Njësi kërkimore dhe zhvillimore brenda Fakultetit
Alumni	Ish-studentët e diplomuar që mbajnë lidhje me institucionin
Integritet Akademik	Parime të ndershmërisë dhe përgjegjësisë në arsimin e lartë

Ky dokument është pronë e Fakultetit të Arteve – Universiteti i Prishtinës. Çdo riprodhim kërkon autorizim paraparak institucional.

KONTAKTI INSTITUCIONAL

Fakulteti i Arteve – Universiteti i Prishtinës/ Rruga “Agim Ramadani” p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë/ **Email:** info@arte.uni-pr.edu/ **Tel:** +383 (0) 38 244 183/ **Web:** <https://arte.uni-pr.edu>